



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 04

Prishtinë, më 30 mars 2011, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C- 203

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Në mbledhje morën pjesë: Arben Gashi – kryetar, Mufera Şinik, Arsim Bajram, Halit Krasniqi, Behar Selimi, Haki Demolli, Armend Zemaj, Albulena Haxhiu, Ardian Gjini, Ibrahim Makolli dhe Jasmina Zhivković.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Petrit Hysaj – OSBE, Rinor Beka – NDI, Isuf Zejna – KDI, Sylë Ahmeti – Kosova sot, Fixhrije Dragaj dhe Alban Krasniqi – praktikant.

Nga Stafi i Komisionit për Legjislacion: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Arben Gashi, kryetar i Komisionit.

Rend i ditës:

Shqyrtimi i Projektligjit për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2011, me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së rendit të ditës.

1. Shqyrtimi i Projektligjit për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2011, me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional

Kryetari- E hapi mbledhjen e Komisionit dhe i njoftoi se Komisioni për Buxhet dhe Financa ka proceduar me amendamentet në Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për shqyrtim.

Disa nga Amendamentet janë kryesisht teknike, mirëpo ka edhe probleme parimore, ajo e cila është diskutuar edhe në mbledhjen e kaluar lidhur me nenin 4 të projektligjit. Ishte i mendimit që ky nen është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Ai citoi nenin 10 të Kushtetutës, që është në kundërshtim edhe me nenin 9 të Ligjit për ndërmarrjet publike. Lidhur me këtë pikë hapi debat.

Albulena Haxhiu- Ripërsëriti qëndrimin e saj se jemi kundër nenit 4 në Projektligjin për buxhetin, sepse në këtë mënyrë po ju hapet rruga Qeverisë dhe e drejta për t'i privatizuar ndërmarrjet publike vetëm me vendimin e Qeverisë. Amendamenti 2, pika a, e riformuluar nga ana Qeverisë nuk ka ndonjë ndryshim rrënjësor nga ideja fillestare. Andaj theksoj edhe një herë që ne jemi kundër shitjes së postës dhe me këtë edhe kundër ndarjes së buxhetit në kurriz të pasurisë së vendit.

Ardian Gjini- Në fjalën e tij tha se amendamentet që kanë ardhur, janë diskutuar në Komisionin për buxhet dhe financa dhe ne kemi pasur përfaqësuesin tonë në atë komision. Andaj edhe nuk ka nevojë të shikohet në detaje. Është neni 4 që duhet të hiqet nga Projektligji për buxhetin ngase cili do vendim për privatizimin e asetëve publike të Kosovës duhet të kalojë nëpër procedura të rregullta, nëpër Kuvendin e Republikës së Kosovës. E kuptojmë rëndësinë e privatizimit, mirëpo mendojmë që nuk është mirë në këtë proces të shkaktohen shkelje të rënda të ligjeve në fuqi dhe kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Arsim Bajrami- Theksoi se kemi diskutuar këtë çështje edhe në mbledhjet paraprake dhe atëherë kam theksuar se nuk ka qenë momenti kur ne duhet të merremi me shqyrtimin e tij, kur nuk jemi Komision Funkcional. Ne jemi Komision kryesor dhe e diskutojmë secilin ligj pasi të përfundojë punën Komisioni Funkcional. Mendoj që duhet t'i përmbahemi kësaj procedure të caktuar me Rregulloren e Kuvendit dhe deklarimi ynë duhet të jetë plotësisht ligjor. Ai në vazhdim tha se meqenëse nuk ka konsensus rreth nenit 4, të deklarohej me votim.

Ibrahim Makolli- Tha se kemi para vetës dy propozime të Komisionit për buxhet dhe financa unë besoj që duhet të votojmë për këto dy propozime, sipas të gjitha gjasave në kuvend nuk ka mundësi që të shkojë vetëm njëri amendament, por do të shkojnë dy amendamente. Prandaj duhet të votojmë, pastaj është në dorën e deputeteve të Kuvendit që të deklarojnë se për cilin amendament votojnë.

Haki Demolli- Ishte i mendimit që neni 4 në këtë draft nuk meriton votim për arsye se ka shkelje drejtpërdrejt të kushtetutshmërisë. Do të kishte qenë mirë të mos bëjmë praktik që vendimet e Qeverisë të futen si pjesë e ligjeve. Ishte i mendimit që neni 4 të hiqet në tërësi në mënyrë që vendimi i Qeverisë të sillet në Kuvend, të ketë diskutime, të njoftohet edhe opinioni i gjerë si po shkon procesi i privatizimit. Propozoi që të hidhen në votim propozimet e Komisionit për buxhet.

Behar Selimi- Në fjalën e tij ju referua nenit 159 të Kushtetutës ku thuhet: “ Të gjitha ndërmarrjet që ishin në tërësi ose pjesërisht në pronësi shoqërore, para hyrjes në fuqi të kësaj kushtetute, do të privatizohen në pajtim me ligjin “. Prandaj këtu nuk shkelet Kushtetuta, kam pasur dilema për ligjin për ndërmarrjet publike lidhur me nenin 9 të tij që është diskutuar në mbledhjen e kaluar. Prandaj mendoj se

ky komision duhet ta shikojë vetëm për nga kushtetutshmëria dhe ligjshmëria, andaj mendojë që me nenin 4, nuk shkelet kushtetuta. Propozoj të hidhen në votim këto dy propozime.

Armend Zemaj- Ishte i mendimit që neni 4 është në kundërshtim me parimet e ligjshmërisë dhe kushtetutshmërisë në Kosovë. Neni 4, edhe riformulimi kur ju është bërë, ka harruar Qeveria e Republikës së Kosovës se këtu thotë është bashkangjitur vendimi i Qeverisë më 09.03.2011, dhe vendimi i Qeverisë i datës 09 mars 2011, ka ardhur për aprovimin në Kuvend të Kosovës. Lidhur me mënyrën e procedimit tha se amendamenti i riformuluar nga Komisioni për buxhet dhe financa nuk bëhet në këtë formë, është gabim nga ana e Komisionit për buxhet dhe kështu po e shkelim rregulloren e punës së Kuvendit.

Halit Krasniqi- Duke u ndërlidhur me diskutimet e paraflësve tha se jemi të ndarë në mendime lidhur me këtë çështje, ka mendime të ndryshme se a duhet të mbetet apo të hiqet neni 4, andaj propozoj që të kalohet në votim.

Haki Demolli- Theksoi se amendamenti 3, ku thotë: Qeveria mund të aprovojë pagesën e paradhënies mbi 30%, kjo nënkupton edhe 100%. Ai ishte i mendimit që ndoshta kishte me qenë një formulim tjetër, ku e kufizon Qeverinë deri në 40,50% e jo të shkohet në këtë formulim.

Pas diskutimeve, Kryetari e vuri në votim, amendamentin 2 pika A, dhe rezultati votimit ishte si vijon:

“ Për “ ishin: Arsim Bajrami, Halit Krasniqi, Behar Selimi, Ibrahim Makolli, Mufera Sinik dhe Jasmina Zhivkoviq.

“Kundër “ ishin: Arben Gashi, Ardian Gjini, Haki Demolli, Armend Zemaj dhe Albulena Haxhiu.

Kryetari konstatoi se Komisioni për legjislacion, me 6 vota “për” dhe 5 “kundër”, përkrahu amendamentin 2 pika (A), propozuar nga Komisioni për buxhet dhe financa dhe lidhur me këtë nxori:

REKOMANDIM

Projektligji për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2011, e ka bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Amendamentet e Komisionit funksional e kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, përveç amendamentit 2 pika (B) e cila nuk u mbështet nga Komisioni për Legjislacion.

Mbledhja përfundoi në orën 12:10

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Arben Gashi